



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 1339 prot.

Shkodër, më 26/05/2020

VENDIM

Nr. 182 date 26.05.2020.

PER MIRATIMIN E MBYLLJES SE PROCESIT MESIMOR NE USH"LUIGJ GURAKUQI" PER VITIN AKADEMIK 2019-2020

Në mbështetje të Ligjit nr. 80 datë 22.05.2017 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Urdhrit të Ministrisë së Shëndetit Publik nr.289 datë 4.05.2020 "Për miratimin e Udhëzuesit për Masat Covid-19 që duhet të marrin Institucionet Arsimore" dhe në mbështetje të Statutit të USH, vendimit të Senatit nr.161 datë 29.04.2020 "Për miratimin e përfundimit online të planit mësimor të çdo programi studimi në USH "Luigj Gurakuqi" për vitin Akademik 2019-2020", Rregullore së studimeve në USH, dhe vendimin e rektoratit nr. 171 datë 20.05.2020 "Rregullore mbi Masat Sanitare për Minimizimin e Riskut nga COVID-19 në USH", Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" në mbledhjen e datës 26.05.2020:

VENDOSI

1. Të mbyllë procesin mësimor online në të gjitha programet e studimit sipas vendimit nr. 161 datë 29.04.2020 të senatit akademik "Për miratimin e përfundimit online të planit mësimor të çdo programi studimi në USH "Luigj Gurakuqi" për vitin akademik 2019-2020" dhe vendimin nr. 332 datë 15.10.2019 të rektoratit "Miratimi i planit kalendarik të procesit mësimor për vitin akademik 2019-2020" duke shtyrë me dy javë mësimin në të gjitha programet e studimit Bachelor dhe Master.
2. Nga data 15.06.2020 deri me 03.07.2020, bazuar në propozimet e departamenteve për organizimin e orëve përmbledhëse në auditor, drejtorët e departamenteve në koordinim me dekanët përkatës të organizojnë grupet e studentëve, duke hartuar listat dhe oraret për hyrje dhe dalje nga godinat duke zbatuar rregulloren e distancimit Social dhe urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 289 datë 4.05.2020 dhe "Rregullore mbi Masat Sanitare për Minimizimin e Riskut nga COVID-19" në USH.

3. Drejtorët e Departamenteve në bashkëpunim me Dekanët në bazë të regjistrimit të studentëve të hartojnë orarin e riprovimeve për kategoritë e studentëve: viti tretë Bachelor studentët e rregullt, studentët stazhierë të vitit tretë Bachelor, studentët e rregullt të vitit të fundit të programeve master dhe studentët përsëritës të vitit të vitit të fundit të programeve master. Sezoni i riprovimit do të jetë 15.06.2020 deri me 03.07.2020, me 6 (gjashtë) data riprovimesh.
4. Në bazë të propozimeve të ardhura nga pedagogët dhe te miratuara nga departamentet, provimet do të organizohen online dhe auditor. Kur provimet organizohen në auditor, Dekani dhe Drejtori i Departamentit që mbulon programin e studimit, marrin masa për organizimin e provimit duke zbatuar rregulloren dhe urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 289 datë 4.05.2020 dhe “Rregullore mbi Masat Sanitare për Minimizimin e Riskut nga COVID-19 në USH”, nga data 04.07.2020 deri me datën 23.07.2020. Për provimet që organizohen online nga pedagogët dhe studentët duhet që të mos ketë kontestime.
5. Periudha kohore 4 korrik deri me 23 korrik, mund të shfrytëzohet për dhënie provimesh online të lëndëve të vitit të I dhe të II Bachelor dhe të studentëve të masterit që nuk përfshihen në pikën 3 të këtij vendimi , në qoftë se programi i lëndës është realizuar plotësisht, në çdo rast duhet miratimi i departamentit.
6. Periudha kohore 24 korrik deri me 7 Gusht 2020, do të jetë periudha e mbrojtjes së diplomave dhe plotësimit të dokumentacionit përkatës lidhur me to.
7. Departamentet që kanë propozuar për organizimin e orëve përmbledhëse në auditor për vitin e parë dhe të dytë të organizojnë grupet e studentëve, duke hartuar listën dhe oraret për hyrje dhe dalje nga godinat duke zbatuar rregulloren e Distancimit Social dhe urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 289 datë 4.05.2020 dhe “Rregullore mbi Masat Sanitare për Minimizimin e Riskut nga COVID-19 në USH”, nga data 24.08.2020 deri me 18.09.2020.
8. Drejtorët e Departamenteve në bashkëpunim me Dekanët në bazë të regjistrimit të studentëve të hartojnë orarin e riprovimeve për të gjithë studentët. Sezoni i riprovimit do të jetë nga data 24.08.2020 deri me 18.09.2020, me 6 (gjashtë) data riprovimesh.
9. Në bazë të propozimeve të ardhura nga Pedagogët dhe te miratuara nga Departamentet, provimet viti I dhe II Bachelor dhe viti i Master, do të organizohen online ose në auditor. Kur provimet organizohen në auditor, Dekani dhe Drejtori i Departamentit që mbulon programin e studimit, marrin masa për organizimin e provimit duke zbatuar rregulloren dhe urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë nr 289 datë 4.05.2020 dhe “Rregullore mbi Masat Sanitare për Minimizimin e Riskut nga COVID-19 në USH”, nga data 21.09.2020 deri me 10.10.2020.
10. Periudha kohore 1.10.2020 deri me 10.10.2020, do të jetë periudha e mbrojtjes së diplomave dhe plotësimit të dokumentacionit përkatës lidhur me to.

11. IT e USH të përzgjedhë platformat për provimin online dhe të organizojë trajnimin e pedagogëve dhe studentëve për zhvillimin e provimeve online.
12. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen dekanët e fakulteteve, drejtorët e departamenteve, pedagogët dhe drejtoria e IT.
13. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Adem Bektashi



Konceptoi

Sekretarja e Senatit Akademik

Pro.as.dr. Mirjam Dibra